eeerer

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Mbledhje e përbashkët

Këshilli për Legjislacionin dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.12.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

Vijimi i procedurës së shqyrtimit të projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 84/2017, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Marrin pjesë:

Gramoz Ruçi, Ulsi Manja, Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Edmond Haxhinasto, Silva Caka, Nasip Naço, Spartak Braho, Bashkim Fino, Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Ermonela Felaj, Adnor Shameti, Alket Hyseni, Edmond Leka, Xhemal Qefalia, Bledar Çuçi, Elena Xhina, Arben Pellumbi

Mungojnë:

Jurgis Çyrbja, Klotilda Bushka Astrit Veliaj, Tom Doshi, Dhurata Çupi, Fatmir Mediu

Të ftuar:

Gledian Llatja – ekspert i propozuar nga deputetët e Partisë Socialiste

Artur Metani – ekspert i propozuar nga deputetët e Partisë Socialiste

Gazmend Bardhi - ekspert i propozuar nga deputetët e Partisë Demokratike

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Të nderuar deputetë,

Hapim mbledhjen e përbashkët të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut së bashku me Këshillin e Legjislacionit.

Rendi i ditës për sot, sipas programit që kemi miratuar, është vijimi i procedurës së shqyrtimit të projektligjit "Për një ndryshim në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë".

Procedura do të vazhdojë me paraqitjen e opinioneve të ekspertëve konstitucionalistë, duke iu përgjigjur pyetjeve që parashtruan deputetët në mbledhjen e datës 3 tetor 2018. Përpara se të fillojmë, sjell në vëmendjen tuaj që procesverbalin e mbledhjes së kaluar e keni marrë në mënyrë elektronike. A ka ndonjë vërejtje për të? Nuk ka.

Procesverbali quhet i miratuar.

Bazuar në kalendarin e shqyrtimit të projektligjit për ndryshimin e Kushtetutës, vijojmë me rendin e ditës. Në datën 3 tetor u njohëm me ekspertët konstitucionalistë dhe lamë detyrat për ta që ata t'i paraqisnin opinionet e tyre me shkrim lidhur me nismën e propozuar, duke iu përgjigjur pyetjeve që bënë deputetët. Ekspertët e përcaktuar si nga pozita dhe nga opozita, siç edhe jua thashë, i kanë paraqitur opinionet e tyre me shkrim dhe ju i keni marrë në rrugë elektronike ato, sot janë shumëfishuar dhe besoj se i keni në tavolinat tuaja të punës.

Ekspertët janë të pranishëm në mbledhje. Do të dëgjojmë opinionet e të nderuarve ekspertë, por do t'ju lutesha në mënyrë të përmbledhur, pasi deputetët e Komisionit të Ligjeve dhe të Këshillit të Legjislacionit i kanë materialet përpara.

Kush do ta marrë fjalën i pari nga ekspertët?

Artan Metani – Unë mendova se do të respektohej nisma propozuese.

Mirëdita zoti Kryetar dhe të nderuar anëtarë!

Duke ju falënderuar, së pari, për besimin tuaj në lidhje me këtë ekspertizë, po ju përmbledh për disa minuta mendimin tonë për këtë çështje.

Nisma për rishikimin e Kushtetutës ka në thelb parashikimin që e drejta për t'u zgjedhur, emëruar apo ushtruar një funksion publik në një nga organet kushtetuese ose të krijuara me ligj, të kufizohet edhe në rastin e shtetasve që kanë kontakte me persona të përfshirë në

krimin e organizuar, si dhe ngritjen e një mekanizmi për garantimin e integritetit të funksionarit publik.

Nga shqyrtimi në tërësi i projektligjit në mënyrë të përmbledhur konstatojmë disa veçori:

Së pari, mungesë qartësie ose paqartësi në kuptimin e fjalës "kontakt". Ligji për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve e jep kuptimin e fjalës apo të togfjalëshit "kontakt i papërshtatshëm", ndërsa projektligji propozues në diskutim parashikon thjesht fjalën "kontakt". Fjala "kontakt" dhe "kontakt i papërshtatshëm", së pari, ndryshojnë literalisht nga njëra tjetra.

Së dyti, gjyqtarët dhe prokurorët janë një kategori e ndryshme zyrtarësh nga politikanët, kështu që edhe natyra e kufizimit të kontakteve të tyre nuk mund të jetë e njëjtë. Gjyqtarët dhe prokurorët janë subjekte që nuk emërohen për një periudhë të caktuar, por përjetë. Parimet e pavarësisë, paanshmërisë dhe parevokueshmërisë që i vishen sistemit të drejtësisë, imponojnë kërkesa më të larta për gjyqtarin dhe prokurorin në raport me politikanin e zgjedhur në drejtim të figurës.

Nga ana tjetër, politikanët zgjidhen për një mandat të kufizuar në kohë, duke qenë të përkohshëm në detyrën e tyre. Po ashtu, edhe kategoria tjetër e zyrtarëve që parashikon ky projektligj, që duhet t'i nënshtrohen procesit të kontrollit të pastërtisë së figurës, zgjidhen me afate kohore të caktuara.

Po të mbajmë parasysh nga njëra anë deputetët dhe kryetarët e bashkive në natyrën e takimeve të tyre, si dhe detyrimin ligjor për t'i takuar periodikisht zgjedhësit, po i referohem ligjit për statusin e deputetit, në takimet ku jo domosdoshmërish i njohin të gjithë njerëzit, si dhe nga ana tjetër, gjyqtarët dhe prokurorët, për të cilët ndalimi i kontakteve të papërshtatshme parashikohet shprehimisht në ligjin për statusin e magjistratit, del apo rezulton se nuk janë në pozita të barabarta.

Jurisprudenca kushtetuese shqiptare në referim të standardeve të vendosura nga jurisprudenca ndërkombëtare e ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës duke u shprehur se: "Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjedhje të njëllojta për individë apo kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia para ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta".

Gjithashtu, në projektligj vërehet mungesë qartësie lidhur me personat e përfshirë në krimin e organizuar. A përfshihen në këtë kategori personat nën hetim? Po personat që e kanë shlyer dënimin?

Së treti, në rrethin e subjekteve në projektligj nuk përfshihen një sërë zyrtarësh, si, për shembull, këshilltarët bashkiakë, anëtarët e këshillave bashkiakë, zëvendësministrat, sekretarët e përgjithshëm të ministrive të linjës dhe të organeve të pavarura apo drejtues të tjerë të nivelit të lartë, ndërkohë që gjithë të zgjedhurit e tjerë synojnë të jenë objekt verifikimi.

Ka paqartësi, gjithashtu, në lidhje me strukturën, e cila do të realizojë vetingun e politikës. Cila do të jetë struktura përgjegjëse që do ta zbatojë këtë proces? Cila do ta emërojë atë? A do të jetë strukturë e njëjtë si për zyrtarët e zgjedhur dhe ata të emëruar, apo e ndryshme?

Drafti i propozuar duhet të jepte të paktën një orientim të përgjithshëm në nivel kushtetues se cilat do të jenë organet kompetente të hetimit apo të konstatimit për të mos u zgjedhur, apo për mbarimin e mandatit.

Në rastin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Kushtetuta ka pranuar një rregullim specifik dhe shumë të hollësishëm, jo vetëm në trungun e saj, por edhe në një aneks të veçantë në lidhje me procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, në drejtim të organizimit institucional të organeve të rivlerësimit, mënyrën e krijimit të tyre, parimin mbi të cilat veprojnë, procedurën që ndjekin, si dhe vendimmarrjes së tyre, që bazohet në atë të një gjykate të caktuar me ligj, rregullim që mungon në projektligjin që propozohet për vetingun e politikës.

Gjithashtu, propozimi i këtij projektligji nuk është shoqëruar me studime apo analiza paraprake me ndikimet e projektligjit, të cilat identifikojnë numrin e subjekteve të prekura, koston në total të propozimit, risqet dhe pasojat, ofrimin e disa opsioneve për të arritur objektin e synuar, parime këto, të cilat vijnë në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare të hartimit të legjislacionit të Komisionit Europian dhe OECD-së.

Kushtetuta, si ligji më i lartë i vendit, si burim dhe kornizë për ligjet e tjera të vendit, si dokument që ka në mision të institucionalizojë sovranitetin dhe autoritetin e shtetit, të krijojë vlera, si qëllim unifikues të saj ka t'i japë stabilitet qeverisjes, të mbrojë liritë dhe të drejtat e njeriut, si dhe të sigurojë funksionim normal të jetës së një vendi, nuk mund të ndryshojë shpesh dhe aq më pak pa kaluar nëpërmjet një procesi të studiuar mirë, afatgjatë dhe gjithëpërfshirës.

Qëllimi i nismës së propozuar, sipas relacionit shoqërues të projektligjit është të garantojë integritetin e personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë një funksion publik nëpërmjet shtrirjes së vetingut edhe te politikanët në detyra shtetërore dhe funksione të tjera kushtetuese.

Ndërkohë, qëllimi kryesor i ndryshimeve që iu bënë Kushtetutës në fund të vitit 2015, ishte garantimi i integritetit të zyrtarëve të lartë, si një parakusht i qeverisjes demokratike dhe i funksionimit të shtetit të së drejtës. Ky qëllim u realizua nëpërmjet ndërhyrjes në tri dispozita të Kushtetutës. Konkretisht, pika 3 e nenit 45, ku janë parashikuar raste të kufizimit të shtetasve për t'u zgjedhur. Neni 179/a, ka përcaktuar ndërprerjen e mandatit të funksionarëve të zgjedhur apo të emëruar në organet kushtetuese dhe të krijuara me ligj, mandat, i cili është fituar para ndryshimeve kushtetuese si dhe neni 6.1, i cili ka parashikuar shprehimisht ndalimin e zgjedhjes, emërimit apo ushtrimit të një funksioni nëse verifikohen rrethana që cenojnë integritetin e funksionarit publik.

Kushtetuta, si një akt integral tërësor i pandashëm, sistematikisht e organizuar dhe drejtpërdrejt e zbatueshme, duhet lexuar, analizuar dhe vlerësuar në mënyrë integrale si një tekst i tërë.

Po kështu, dispozitat e projektligjit të vetingut të politikës nuk mund të analizohen si një nismë e pavarur, por duhen studiuar me kujdes në raport me kuadrin kushtetues, ligjor dhe institucional të miratuar në Shqipëri edhe si rrjedhojë e reformës në sistemin e drejtësisë.

Pa qenë nevoja e ndryshimeve kushtetuese, nisur nga rregullimi i nenit 6.1, por edhe nga kuptimi shumë i zgjeruar që ka termi "integritet", është në vullnetin e ligjvënësit për të ndërmarrë nismën, për të përfshirë në objektin e ligjit që garanton integritetin e funksionarëve të zgjedhur apo të emëruar edhe subjekte që rezultojnë se kanë kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që nuk arrijnë të justifikojnë ligjërisht pasurinë e tyre.

Sa i takon projektligjit të propozuar, vërejmë se nuk është në përputhje edhe me standardet e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Preket në mënyrë jo proporcionale e drejta për t'u zgjedhur dhe garancitë e parashikuara nga neni 3 i protokollit 1 të Konventës Europiane. Për sa parashikohet edhe në vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut "Scoppola kundër Italisë", të vitit 2018, shtrëngimet duhet të kufizohen për aq sa është e nevojshme për të siguruar funksionimin e duhur të demokracisë dhe jo të cenohen të drejtat dhe liritë politike.

Të dhënat që janë objekt i verifikimit, i aplikimit përbëjnë të dhëna që lidhen me jetën private, për këtë arsye kjo ndërhyrje replikon edhe nenin 8 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me mbrojtjen e reputacionit. Në çështjen "Petrenko kundër Moldavisë" në vitin 2010 Gjykata Europiane është shprehur se statusi i personit si politikan ose figurë tjetër publike nuk heq nevojën për një bazë të caktuar faktesh për të publikuar deklarata që dëmtojnë reputacionin e tij.

Nga ana tjetër, procedura për përjashtimin e mandatit të të zgjedhurit lidhet edhe me standardin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 61 i Konventës Europiane. Sipas jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, në rast se një person nuk është dënuar ende, privimi i të drejtave politike është në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë, për shembull rasti "Kapka kundër Polonisë" në vitin 2000 ose rasti "Kortova kundër Italisë" në vitin 2003.

Në pikën 2 të nenit 176 /1 të projektligjit parashikohet se kontrolli i figurës do të kryhet mbi bazën e parimit të procesit të rregullt, si edhe duke respektuar të drejtat themelore të individit. Ky parashikim gjithsesi nuk shmang cenimin që mund të vijë nga zbatimi i tij. Pra, për aq kohë sa nuk parashikohen procedurat dhe organet që do të kryejnë verifikimin, ky parashikim mbetet si dispozitë referuese me karakter deklarativ.

Sa më sipër projektligji i propozuar paraqet, sipas mendimit tonë, së pari, mangësi në drejtim të parashikimit të nivelit kushtetues të mënyrës së zbatimit të procesit të garantimit të integritetit të funksionarit publik, së dyti, kufizim e të drejtave themelore të subjekteve mbi të cilat parashikon të shtrijë efektet pa respektuar parimin e proporcionalitetit, së treti, mundësi për dublim në mënyrë të papërshtatshme dhe pengim të zbatimit të dispozitave që rregullojnë funksionimin e Gjykatave të Posaçme, Prokurorisë së Posaçme, Byrosë Kombëtare të Hetimit, ILDKP-së dhe institucioneve përgjegjëse që merren me procesin e dekriminalizimit.

Gramoz Ruçi- Do të dëgjojmë edhe zotin Bardhi, pastaj vazhdojmë me pyetje nga deputetët.

Zoti Bardhi, keni fjalën.

Gazmend Bardhi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Iniciativa e propozuar parashikon kufizimin e të drejtës për të zgjedhur në rast specifik, duke ngritur një sistem kontrolli të figurës së një kategorie të lartë zyrtarësh publikë, konkretisht atyre me status kushtetues ose që zgjidhen nga Kuvendi.

Në këtë kuptim në pikëpamje të Kushtetutës do të duhet të vlerësohet nëse kufizimi është ose jo i mundur sipas standardeve kushtetuese, të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe të Komisionit të Venecias.

Zgjedhja ose emërimi në një funksion publik, përveçse përbën një të drejtë themelore, përbën në të njëjtën kohë një interes të lartë publik për funksionimin e shoqërisë demokratike dhe mirëqeverisjen.

Kushtetuta lejon kufizimin me ligj të të drejtave aktualisht, me ligj të të drejtave themelore për një interes publik pa cenuar thelbin e së drejtës. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur në mënyrë konstante edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe Komisioni i Venecias.

Kufizimi me ligj për një arsye legjitime të demonstruar qartë dhe në proporcion me këtë qëllim i të drejtave të caktuara politike, përfshirë atyre zgjedhore, është i pranueshëm në një shoqëri demokratike si një masë që synon mbrojtjen e sistemit të vlerave demokratike dhe institucioneve përkatëse nga influenca qofshin edhe kriminale në përzgjedhjen e zyrtarëve, politikëbërjen dhe vendimmarrjen. Një kufizim i tillë posaçërisht i drejtës për t'u zgjedhur nuk parashikohet dhe nuk mund të konsiderohet si një sanksion penal ose administrativ, por një masë për mbrojtjen e funksionimit demokratik të organit.

Deputeti, ministri, drejtuesit dhe anëtarët e institucioneve të tjera kushtetuese janë bartës të besimit publik njëlloj si gjyqtarët dhe prokurorët. Në këtë drejtim marrëdhëniet e ngushta me eksponentë të krimit të organizuar njëlloj si edhe për rastin e gjyqtarëve dhe prokurorëve cenojnë në themel besimin publik mbi institucionet shtetërore të prekura nga ky fenomen, si edhe interesin publik për funksionimin demokratik të institucioneve kushtetuese dhe ligjore. Për pasojë kjo masë e propozuar nga projektligji, në vlerësimin tim, është veçanërisht e nevojshme dhe legjitime po të mbahet në konsideratë fakti se Shqipëria aplikon një sistem elektoral me lista të mbyllura, që i pamundëson votuesit të lërë jashtë institucionit kandidatët që identifikon se kanë lidhje me krimin e organizuar.

Gjithashtu, Shqipëria aktualisht nuk aplikon rregulla të mjaftueshme që sigurojnë funksionimin demokratik të partive politike, ose që sigurojnë mospërfshirjen e individëve me figurë morale të cenuar si pasojë e lidhjeve me krimin e organizuar. Në këtë kuptim ka një

interes të përgjithshëm publik për të shmangur rolin aktiv në politikëbërje të personave të lidhur me krimin e organizuar, sepse zgjedhja e votuesve, nëse kandidatë të tillë mund t'i ofrohen, është e njëanshme nëse votuesit dorëzohen para presionit të këtyre individëve. Në demokraci duhet garantuar që personat që konsiderohen nga shumica e votuesve si të papërshtatshëm për të vendosur për interesat e tyre të qëndrojnë larg vendimmarrjes legjislative ose qeverisë.

Qëllimi i kufizimeve i propozuar nga drafti ka pikërisht këtë synim, mbrojtjen e funksionimit demokratik të institucioneve nga ndikimi i krimit të organizuar. Është interes i lartë publik që politikëbërja dhe vendimmarrja të imunizohem nga ky ndikim, për pasojë pyetja e parë që duhet të shtrohet në nivel kushtetues është nëse kufizimi ka ose ndjek qëllimin legjitim. Përgjigjja është: po, qëllimi është legjitim. Ky është kushti i parë i vendosur nga neni 8 i Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut për kufizimin e të drejtave, konkretisht për kontrollin e figurës dhe të nenit 3 protokollit1 sa i përket të drejtës për t'u zgjedhur.

Kushti i dytë që duhet të shqyrtohet në nivel kushtetues është nëse iniciativa respekton ose jo parimin e proporcionalitetit. Neni 17 i Kushtetutës aktualisht mundëson kufizimin e një të drejte të parashikuar nga Kushtetuta nëse ky kufizim vendoset me ligj që do të thotë se kriteret që lidhen me respektimin e parimit të proporcionalitetit, mbi të gjitha do të duhet të garantohen nga ligji zbatues. Konstatohet që amendamenti kushtetues nuk parashikon organin që do të duhet të bëjë verifikimin e kontrollit të figurës së këtyre zyrtarëve që parashikon iniciativa. Fakti që amendamenti nuk parashikon një organ të ri kushtetues që i ngarkon detyrën e kryerjes së kontrollit figurës për këta zyrtarë, në vlerësimin tim, nënkupton që do të jetë një organ ekzistues kushtetues. Për këtë arsye iniciativa ka deleguar përcaktimin e organit kushtetues, të cilit do t'i ngarkohet kjo detyrë verifikimi ligjin e posaçëm që do të dalë në bazë dhe për zbatim të këtij amendamenti kushtetues.

Një gjë duhet të kihet në konsideratë sa i përket përcaktimit të organit që do t'i ngarkohet detyra e realizimit të kontrollit të figurës që e para do të duhet të jetë një organ i pavarur dhe që do të japë të gjitha garancitë për respektimin e të drejtës së parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, sipas të cilit askujt nuk mund t'i kufizohen të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara nga Kushtetuta pa një proces të rregullt ligjor. Kushdo për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Ky është një standard që ekziston aktualisht në Kushtetutë dhe që do të duhet, edhe në respekt të garantimit të së drejtës të

sanksionuar nga neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut të mbajnë në konsideratë caktimin e organit që do të duhet t'i ngarkohet kjo detyrë.

Së dyti, për shkak të kufizimit në kohë të dallimit që ka midis zyrtarëve publikë që përfshihen në draft dhe gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk mundet kurrsesi që të jetë i njëjti mekanizëm që kryen kontrollin e figurës si në rastin e gjyqtarëve dhe prokurorëve jo për shkak se gjyqtarët dhe prokurorët emërohen përjetë, sepse anëtarët e Gjykatës Kushtetuese që i nënshtrohen procesit të vetingut janë me mandat si deputetët, por ata e kanë 9- vjeçar. Në të njëjtin rregull futet edhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë, që, gjithashtu, i nënshtrohet vetingut, pasi edhe ai nuk ka mandat përjetë, është me mandat kohor të përcaktuar njëlloj si deputetët. Po ashtu edhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor apo të Këshillit të Lartë të Prokurorisë i nënshtrohen gjithashtu procesit të vetingut, janë pa mandat, pra nuk janë të emëruar përjetë, por fakti që ka një dallim sa i takon statusit të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe statusit të personave të zgjedhur do të duhet që mekanizmi që aplikohet të jetë i ndryshëm. Në respekt të parimit të proporcionalitetit do të duhet që ligji zbatues, nëse amendamenti miratohet, i cili do të dalë në bazë dhe për zbatim të këtij amendamenti, do të duhet të bëjë një qartësim të subjekteve që do t'i nënshtrohen vetingut sipas këtij amendamenti, duke qenë, fjala vjen koncepti i institucioneve të krijuara me ligj është i padefinuar aktualisht në legjislacionin në fuqi.

Gjithashtu, edhe termat kyçë të përdorur në amendamentin kushtetues janë të një natyre të përgjithshme dhe do të duhen të detajohen nëpërmjet një përkufizimi të qartë dhe shterues, pikërisht për të respektuar parimin e qartësisë dhe të sigurisë ligjore, për të shmangur interpretimet arbitrare dhe abuzive, të cilat do të sillnim cenim të parimit të proporcionalitetit.

Aktualisht, nuk ka një përkufizim se kush do të konsiderohet personi i përfshirë në krimin e organizuar apo kush do të konsiderohet kontakt, pasi këto do të duhet të përcaktohen në mënyrë të qartë në ligjin zbatues, për të shmangur çdo interpretim abuzues për përkufizimin e të drejtës dhe lirisë për të zgjedhur. Është e vërtetë që amendamenti përdor termin "kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar", por sjell në vëmendje të komisionit që jo çdo kontakt mund të konsiderohet dhe nuk do të duhet të konsiderohet si i paligjshëm, prandaj do të jetë detyrë e legjislacionit zbatues të përcaktojë se cili kontakt do të sjellë kufizimin e së drejtës për të zgjedhur, cili kontakt do të sjellë lënien e mandatit të deputetit apo shkarkimin nga detyra të një ministri, kryeministri apo funksionarëve të tjerë kushtetues, duke përcaktuar gjithmonë një përkufizim të qartë dhe që nuk lë shteg për abuzime.

Gjithashtu, është e nevojshme në funksion të parimit të proporcionalitetit në të njëjtën standard, siç është ndjekur edhe në kufizimin e të drejtës për t'u zgjedhur, që u bë në kuadrin e reformës së dekriminalizimit, të përcaktohet periudha kohore që do t'i nënshtrohet procesit të verifikimit, si dhe një periudhë kohore ndalimi dhe veprimi të kufizimit, për shkak se standardet e përcaktuara nga Komisioni i Venecias edhe në rastin e dekriminalizimit nuk lejojnë kufizimin përjetë të të drejtës për t'u zgjedhur.

Sa i takon pyetjes nëse ky amendament pengon apo mbivendoset me kompetencat aktuale të organeve të reja të drejtësisë apo Inspektoratit të Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive apo me institucionet që merren me procesin e dekriminalizimit, e cila është pyetja e fundit e deputetëve të maxhorancës, koncepti i vetingut është një koncept krejtësisht i ndryshëm nga ai i ndjekjes penale. Ashtu siç është përcaktuar edhe në raportin e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, i cili nxit shtetet që janë me demokraci jo të konsoliduar për të futur në legjislacionin e tyre një proces vlerësimi të integritetit të zyrtarëve publik, vetingu është një proces administrativ që kontrollon cilësitë dhe integritetin një personi si rregull përpara se atij t'i ofrohet ose të marrë një post publik.

Pra, është një masë që frenon emërimin në funksione kushtetuese të individëve, të cilët nuk përmbushin kriteret e pastërtisë së figurës së tyre. Ndërkohë që ndjekja penale, e cila ushtrohet nga organet e drejtësisë, kur të ngrihet, do të ushtrohet edhe nga Byroja Kombëtare e Hetimit apo nga SPAK-u dhe më pas gjykatat antikorrupsion, kanë për detyrë kushtetuese të ushtrojnë ndjekjen penale në emër të shtetit. Të ushtrosh ndjekjen penale do të thotë të bësh përgjegjës një person për kryerjen e një vepre penale.

Ndërkohë që projektligji apo kontrolli i propozuar sipas sistemit në amendamentin kushtetues nuk mbivendoset me kompetencat e Inspektoratit të Lartë të Kontrollit të Deklarimit të Pasurive, i cili ka një mision për të kontrolluar në mënyrë periodike deklarimet e pasurive të një numri të caktuar zyrtarësh.

Zoti Kryetar, kaq kisha. Nëse ka pyetje, jam i gatshëm t'u përgjigjem.

Gramoz Ruçi – Faleminderit i nderuar, për gjithë punën serioze që keni bërë!

Ekspertët, në përmbushje të misionit të tyre lidhur me pyetjet e shtruara nga anëtarët e Këshillit të Legjislacionit dhe nga anëtarët e Komisionit të Ligjeve, kanë dhënë këtë produkt, të cilin, siç jua thashë edhe fillim, e keni të gjithë përpara. Në qoftë se ka ndonjë pyetje lidhur me atë çka ata kanë paraqitur, mund ta bëni, por besoj se problemet janë të qarta.

Do të kërkoja mirëkuptimin e të gjithë kolegëve të pranishëm që këtu të mbyllet çështja e parashikuar në kalendar, dëgjimi i opinioneve të ekspertëve. Gjithashtu, do të kërkoja edhe mirëkuptimin e medies për të na falur, sepse do të diskutojmë dy probleme organizative me njëri-tjetrin për vazhdimin e punës më tej. A jeni dakord? Keni ndonjë vërejtje?

(Diskutime pa mikrofon)

E kisha për vazhdimin e rendit të ditës dhe të punës për më tej...

(Diskutime pa mikrofon)

Pikërisht për këtë e kisha, nuk kam ndonjë gjë, media le të rrijë.

Në rregull, se do të thonë pastaj mediet që na nxorën jashtë.

Kisha dy çështje. Ne kemi miratuar një kalendar deri ditën e sotme, datë 05.12.2018, ku do të dëgjonim mendimin e ekspertëve, por nuk kemi përcaktuar kalendarin se kur do të diskutojmë raportet dhe kur do të përgatiten raportet nga relatorët dhe ne më pas të bëjmë diskutimin në parim dhe nen për nen. Ajo që unë kam është që kërkesat e Kushtetutës janë, që në ditën që komisioni mbaron punë, do të duhen jo më pak se dy javë dhe jo më shumë se tri javë, që shënon limitet e këtij sesioni parlamentar. Si drejtues i kësaj mbledhjeje dhe si drejtues i parlamentit, nuk kam asnjë vërejtje për ta kaluar brenda këtij sesioni në lidhje me atë që është ngritur shpesh edhe në këtë mbledhje, për ta shtyrë në kalendat greke.

Çështja qëndron në faktin, ashtu siç e ka marrë vesh edhe publiku shqiptar, që ne i kemi bërë një kërkesë Komisionit të Venecias. Komisioni i Venecias, të cilin e falënderoj, ka nisur këtu ekspertët, të cilët kanë bërë takime me të gjithë aktorët dhe faktorët politikë lidhur me nismën dhe gjej vendin për t'i vlerësuar, pasi nisma dhe kërkesa e bërë Komisionit të Venecias është vlerësuar maksimalisht, duke e futur në këtë vit kalendarik të punës dhe të veprimtarisë së tyre, pasi pjesa tjetër ngelej për muajin mars, atëherë nisma vinte vërtet për kalendat greke, siç është quajtur, është në datën 13 dhe 14.

Si Kryetar i Kuvendit mua më ka ardhur kërkesa nga të tria grupimet politike për të marrë pjesë, sigurisht ka ardhur edhe një ftesë për mua personalisht ose të dërguarit e mi, përfaqësuesin tim, kështu është ftesa. Grupet parlamentare të interesuara kanë bërë kërkesë, si Partia Socialiste, Partia Demokratike, ashtu edhe Lëvizja Socialiste për Integrim, pavarësisht se kanë pasur një problem: një nga propozimet e bëra nga opozita nuk është i një deputeti dhe në praktikën parlamentare nuk dërgohet. Megjithatë, po njoftoj Komisionin e Ligjeve dhe Këshillin e Legjislacionit që unë i kam miratuar sot të gjitha propozimet dhe ua kam kaluar shërbimeve të

Kuvendit. Do të ketë 3 përfaqësues të pozitës, 3 të opozitës, pra 2 nga PD-ja dhe 1 nga LSI-ja, sipas propozimeve të bëra, që do të jenë në Komisionin e Venecies.

Tani, çështjen e kam për kërkesën e Kushtetutës. Sigurisht, ndoshta sot relatorët dhe grupimet politike nuk janë të gatshme të më japin një përgjigje nëse e zhvillojmë dot ose jo mbledhjen ditën e premte të kësaj jave, për të kapur kalendarin në përputhje me Kushtetutën, jo më pak se dy javë dhe jo më shumë se tri javë.

Dua të më jepni një përgjigje pas kësaj mbledhjeje, pasi të konsultohem me ju. Kjo ishte çështja e parë.

Së dyti, si Kryetar i Kuvendit më është nisur opinioni paraprak i Komsionit të Venecies. Deri më sot nuk është marrë vesh gjë, sepse është i papërkthyer, se në këtë vend nuk mbetet gjë pa u marrë vesh. Kam qenë në dilemë (kjo varet nga mua) ta vë në dispozicion të kujt apo të mos e vë?

Të lutem!

(*Ndërhyrje pa mikrofon*)

Urdhëro?

(*Ndërhyrje pa mikrofon*)

Tani jemi në mbledhje. Unë do t'u vë në dispozicion grupimeve politike kopjen përkatëse të draftit të opinionit paraprak, që ka ardhur nga Komisioni i Venecies, për dy arsye: së pari, që të jetë në funksion, në qoftë se do të vendoset ta bëjmë këtë javë mbledhjen dhe, veçanërisht, meqë ka një interesim kaq të madh nga grupimet politike, që do të marrin pjesë në Komisionin e Venecies, ato duhet ta dinë, sepse do të marrin fjalën atje për të shprehur opsionet e tyre për agjendën e Komsionit të Venecies, në rastin konkret të Shqipërisë.

Këto dy çështje kisha për t'ia komunikuar mbledhjes, kolegë deputetë.

Kështu që, siç e thashë, nëse ka... Zoti Alibeaj tha se duhet të konsultohemi, apo jo?

(*Ndërhyrje pa mikrofon*)

Atëherë, aq më mirë.

Enkelejd Alibeaj – E nise fjalën me "të zbatojmë Kushtetutën dhe të respektojmë Rregulloren".

Kushtetuta dhe Rregullorja thonë se amendamenti që ka paraqitur krahu këtej, në fund të fundit, është një projektligj, i cili në maksimumin e tij do të duhej të miratohej brenda 8

javëve, duke futur këtu edhe segmentin e respektimit të konsultimit publik dhe të ekspertëve, jo më shpejt se dy dhe jo më vonë se tri javë.

E kemi paraqitur shumë kohë më parë amendamentin. Ju kemi kërkuar ta miratonim. Keni kërkuar ta shtyni. E çuat në Venecie. Të gjitha ishin kërkesa dhe tendenca për ta shtyrë e për ta shtyrë në kalendat greke.

Ne e kemi paraqitur amendamentin. Kemi dhënë edhe relacionin. Respektuam Rregulloren me anë të paraqitjes së ekspertëve, respektuam edhe ekspertët e Komisionit të Venecias, i trajtuam çështjet dhe ua sqaruam.

Ne jemi shumë të qartë për atë që ka nevojë vendi, për dramën e madhe që e ka kapluar këtë vend dhe për nevojën ulëritëse për t'i dhënë zgjidhje. Ia kemi dhënë zgjidhjen me amendamente kushtetuese. Kërkohet vetëm një gjë, një orë e më parë: të votohet. Kaq. Kjo është kërkesa, pretendimi dhe nevoja që kemi ne.

Oerd Bylykbashi – Kam diçka fare të shkurtër procedurale, zoti Kryetar.

Ju ngritët një çështje për materialin. Besoj se detyrimi i Kuvendit është të respektojë edhe rregullat e Komisionit të Venecias.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi –Edhe një herë, se nuk e mora vesh.

(*Ndërhyrje pa mikrofon*)

Më duket se edhe unë thashë të njëjtën gjë kur e parashtrova, apo jo?

(*Ndërhyrje pa mikrofon*)

Jo, unë e shtrova shqetësimin shumë të drejtë që keni ju.

Mirë atëherë, e mbyllim mbledhjen.

Faleminderit!